

BULETINI MUJOR KOMUNAL

KOMUNA RAHOVEC- QERSHOR 2020

BULETINI MUJOR KOMUNAL

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE	3
PËRFUNDIM	10

BULETINI MUJOR KOMUNAL

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji qershor i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.

Përmes këtij buletini do paraqiten edhe aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi dhe drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.

BULETINI MUJOR KOMUNAL

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTOREVE TË DREJTORIVE



Kryetari Latifi i shoqëruar nga Nënkyetari, z.Fatmir Iska dhe drejtoresha e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka, kanë vizituar punimet të cilat po kryhen në projektin: "Rregullimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore" në fshatin Dejnë.

Bashkëbisedim i Kryetarit, z.Smajl Latifi me inxhinerë dhe arkitektë të rinj të komunës së Rahovecit, të cilët kanë marrë përsipër avokimin te të rinxjtë për parandalimin e dukurive negative dhe përfshirjes sa më të madhe të tyre në aktivitete sportive e kulturore.



Kryetari Latifi ka zhvilluar një takim me zyrtarë komunal, për shikimin e mundësive të mbajtjes së një Konsultimi Publik me kryetarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Rahovecit, përmes një platformeje online, takimi online është mbajtur, metodë kjo përmes së cilës synohet që transparencia të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me Nënkyetarin, z.Fatmir Iska, kanë zhvilluar një takim pune me drejtorin e Inspektoratit Komunal, z.Besnik Hoti dhe Komandantin e Stacionit Policor në Rahovec, z. Fazli Morina, në kuadër të menaxhimit të situatës me Covid-19.



BULETINI MUJOR KOMUNAL



Bashkë me drejtorin e Bujqësisë, z.Berat Duraku dhe drejtorin e Ekonomisë, z.Artan Asllani, Kryetari Latifi ka vizituar fermerin vreshtar Osman Zyberaj nga Drenoci, i cili aktualisht ka të mbjellur mbi 6 ha, sipërfaqe vreshtare. Komuna e Rahovecit mbetet e përkushtuar, mbështetjen për prodhuesit bujqësor ta vazhdoj dhe në të njëjtën kohë do të jetë pranë tyre për të parë nga afër ecurinë e veprimtarive.

Bashkë me drejtorin e DSHP-së, z.Përparim Krasniqi, Kryetari, z.Smajl Latifi ka zhvilluar një takim pune me Kryeshefin Ekzekutiv të KRU "Gjakova" z. Ismet Ahmeti dhe zyrtarë të lartë të kësaj kompanie. Në takim u diskutua rreth bashkërendimit të investimeve në sektorin e ujit të pijshëm dhe dobinë që do të sjellin projektet e përbashkëta, në mes të komunës së Rahovecit dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Gjakova".



I shoqëruar nga drejtori i DKA-së, z.Avni Morina, Kryetari Latifi ka pritur në takim menaxherin për Kosovë të Caritasit Zviceran, Albert Bakalli dhe menaxheren nga kjo organizatë, Krenare Lleshi. Në takim u nënshkrua marrëveshja në kuadër të projektit "SHPRESE", qëllimi i së cilës është përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe ofrimit të shërbimit në arsimin parafillor (APF), duke përfshirë edhe punën me edukatorët para-shërbimit dhe atyre që janë duke punuar, si dhe institucionet e tjera lokale relevante.

BULETINI MUJOR KOMUNAL

Kryetari, z.Smajl Latifi ka mbajtur Debatin e parë Publik për këtë vit me qytetarët e komunës së Rahovecit, në të cilin ka paraqitur angazhimin e tij dhe të qeverisë që drejton si dhe projektet që janë realizuar për periudhën 6 mujore të vitit 2020. Në këtë takim theks i veçantë u vu tek projektet që janë realizuar me sukses dhe ato të cilat janë në fazën përfundimtare të finalizimit të tyre.



Në Ditën e Çlirimit të Rahovecit Kryetari Latifi, me bashkëpunëtorë, invalidë e veteranë, familjarë të të rënëve përliri, bënë homazhe dhe nderime në varrezat e dëshmorëve dhe vendet që kujtojnë ata që sakrifikuanc gjithçka për të arritur në këtë ditë!



Lavdi!



Në një seancë solemne të Kuvendit Komunal, në kuadër të 21 vjetorit të Ditës së Çlirimit të Rahovecit me rrëthinë, Kryetari Latifi i dorëzoi vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi, Urdhërin:"Hero i Kosovës", familjarëve të viganëve të kombit tonë, pishtarëve të lirisë, Nesimi Elshani, Halim Hoti, Agron Fetahu dhe Hilmi Krasniqi, të cilët ranë gjatë demonstratave përliri, në Brestoc, më 27 janar të vitit 1990!



PËRURUHET LAPIDARI KUSHTUAR SHTATËMBËDHJETË MARTIRËVE NGA FSHATI GURI I KUQ TË RËNË MË 31 MARS 1999!

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Ka vazhduar zbulimi i pllakave përkujtimore për ndër të 14 qershorit. Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit. Mirënjohje dhe vlerësim përjetë për familjet që i kthyen shtëpitë e tyre në baza të UÇK-së.

Kryetari, z.Smajl Latifi ka pritur në takim ambasadoren e Finlandës në Kosovë Pia Stjernvall, ku fillimi shi e falënderoi për kontributin e shtetit që përfaqëson, gjatë gjithë etapës së zhvillimit të Kosovës si dhe vullnetin e kurdohershëm që të mbështetë e shtyjë përpara agjendën integruese të Kosovës.



Në vazhdën e realizimit të projekteve infrastrukturore ka filluar asfaltimi i rrugëve në qytet në kuadër të projektit "Mermetimi rrugëve". Ky projekt është investim i Komunës së Rahovecit, i cili ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe lehtësimin e qarkullimit për qytetarët.



Me qëllim të ngritjes së transparencës, në mënyrë që t'i mbajmë të informuar qytetarët e komunës së Rahovecit, për gjendjen aktuale në komunën tonë Kryetari, z.Smajl Latifi ka mbajtur Konsultim Publik, me kryetarë dhe anëtarë të këshillave të lagjeve dhe fshatrave të komunës së Rahovecit.

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Kryetari Latifi ka nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Sipas këtyre marrëveshjeve, MZHR bashkë me Komunën e Rahovecit do të financojnë dy projekte, konkretisht: projektin: "Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe kabinave inovative" në vlerën: 100.000 euro, si dhe projektin: "Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht", në vlerën: 30.000 euro.

Ndërtimi i rrugës Rahovec-Xërxe!

- Zgjerim, trajtim të ujërave fekale dhe atmosferik,
- Instalime nëntokësore, ndriçim publik,
- Trotuare, ura, mure mbrojtëse, rrethrrrotullime.



Vazhdimesh po kujdesemi në mirëmbajtjen e hapësirave publike!

- Larje,
- Prerje e vegjetacionit,
- Pastrimi i kanalit,
- Mirëmbajtje e memorialeve,
- Mirëmbajtje e varrezave... etj.



Kemi filluar me rrënimin e objekteve pa leje në fshatin Krushë e Madhe. Projekti do të implementohet në tërë territorin e komunës së Rahovecit.



BULETINI MUJOR KOMUNAL



Drejtori i DUPMM-së, z.Rumir Zhuniqi bashkë me drejtorët Afrim Limani e Berat Duraku, vizituan vendin ku po ndërtohet shtrati i lumbit ndërmjet Krushës së Madhe dhe Celinës, në mënyrë që në të ardhmen të evitohet rreziku i vërvshimeve që ka sjell aq shumë dëme në bujqësi e amvisëri. Së shpejti ky projekt do të jetë i përfunduar dhe qytetarët e kësaj ane do të jenë më të mbrojtur.



Ka filluar furnizimi i shkollave me lëndë djegëse (dru) për ngrohje gjatë dimrit. Pamjet janë në oborrin e shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc.



Po vazhdojnë punimet në objektin e ri të shkollës "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël-Brestoc. Ka përfunduar faza e parë e instalimit të ngrohjes qendrore, përkatësisht është bërë instalimi i gypave përcues të ngrohjes dhe janë bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e lyerjes (suvatimit) dhe fasadimit të mureve të brendshme.

Në shkollen "Nesimi Elshani" në Nagavc ka filluar të zbatohet projekti i eficiencës së energjisë. Fillimi është përfunduar pastaj do të bëhet instalimi i ndriçimit eficient, pastaj do të bëhet instalimi i ngrohjes qendrore dhe punët tjera të parapara sipas projektit. Urime mësimdhënësve dhe nxënësve të kësaj shkolle!



BULETINI MUJOR KOMUNAL



Në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj", kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka mbajtur konsultim publik me grupe të interesit dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën e Rahovecit.



Aktivitet "Art në Natyrë" për ndër të Ditës së Çlirimtë Komunës së Rahovecit. Pjesëmarrës në aktivitet ishin nxenesit e grup moshave të ndryshme, të cilët e shprehen talentin e tyre përmes pikturimit.

BULETINI MUJOR KOMUNAL

PËRFUNDIM

*Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:
(qershor 2020).*

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iuh dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjeter përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, qershor 2020